



UDHËZUES TEKNIK

Si të përdoret pa rrezik gazi butan!

Ky udhëzues i adresohet shkollave, çerdheve, familjeve dhe publikut të gjerë.

Ky udhëzues është përgatitur nga Bashkia Vlorë dhe Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë.

Falenderojmë për kontributin:

Jeton Puka; Robert Murataj; Artur Lazaj; Nertila
Përrallaj; Kastriot Merkaj; Melaize Selami; Kanan
X; Elton Qëndro.

Fotot:

Qendra e Informacionit Aarhus (faqe 1);

Përdorimi i bombolave cilindrike të madhësive prej 4.5 kg, 7 kg, 12 kg dhe 15 kg

Ky udhëzues është përgatitur nga Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë dhe Bashkia Vlorë në kuadrin e projektit rajonal “Reduktimi i Rrezikut të Katastrofave dhe Siguria në hapësirën e OSBE-së”. Vendet e projektit përfshijnë Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Serbinë, Mali i Zi. Në Shqipëri projekti është i zbatuar nga Prezenca në Shqipëri. Projekti zbatohet me mbështetjen financiare të Zvicrës.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë medeomos mendimet e OSBE-së dhe donatorit të tyre.

Pasqyra e udhëzuesit

1. Çfarë të kemi parasysh gjatë përdorimit të bombolave të gazit	4
2. Cfarë duhet të evitoni gjatë përdorimit të bombolave të gazit	5
3. Monoksidi i Karbonit.....	6
4. Rregullatori.....	6
5. Tubat fleksibël të gazit	6
6. Këshilla të rëndësishme në rast emergjent.....	7
7. Lidhja e një cilindri 4.5 kg butan	8
8. Çmontimi i një pajisje nga bombola me gas butan 4.5 KG.....	8
9. Montimi i bombolave me gas butan 7 kg, 12kg dhe 15kg	9
10. Çmontimi i bombolave me gas butan 7 kg, 12kg dhe 15kg.....	10

1. Çfarë të kemi parasysh gjatë përdorimit të bombolave të gazit

- Përdoreni bombolën me shumë kujdes me qëllim që të mos dëmtohet valvula;
- Kur përdorni një bombël 4.5 kg mbani parasysh që të vendosni gominën e duhur plastike të përshtashme për këtë bombël;
- Vendoseni bombolën gjithmonë në pozicion vertikal, përveç rasteve kur ka funksion të përcaktuar ndryshe sipas rastit;
- Dorëzoheni bombolën në pikat e autorizuara kur ajo është bosh ose kur nuk është në përdorim për një kohë të gjatë;
- Lexojini me kujdes udhëzimet dhe etiketat e vendosura në pajisjen tuaj dhe i ruani ato që ti rilexoni herë pas herë;
- Pastrojini pajisjet tuaja/bombolat, gjithmonë dhe paraqiteni atë për shërbime periodike pranë pikave të autorizuara. Kjo gjë jo vetëm që do t'ju ndihmojë për ta mbajtur atë të sigurt, por gjithashtu do jetë më efikase dhe do t'ju kursej lekë;
- Sigurohuni që gjithmonë ka një dritare hapur tek ambienti/dhoma ku është vendosur bombola e gazit. Nëse ambienti/dhoma, ka ventilatorë ose grila, i lini ato gjithmonë hapur kur përdorni gazin. Nëse ajri në ambientin/dhomën ku mbani bombolën rëndohet, hapni menjëherë një dritare ose derë;
- Ndërrimin e kokës së bombolës bëjeni gjithmonë jashtë ambienteve të mbyllura. Nëse kjo gjë nuk është e mundur atherë ndërrimi i kokës së bombolave në ambiente të mbyllura mund të bëhet vetëm pasi të jeni të sigurt se nuk keni afër asnjë vatër apo burim zjarri si, oxhak, kaldajë, ngrohje elektrike, cigare ndezur etj. Gjithashtu bombola duhet të jetë e fikur dhe mundësisht e ftohtë para ndryshimit të kokës;
- Bëni kujdes kur e ngrini bombolën e mbushur për ta zhvendosur nga një vend në një tjetër. Bombola e mbushur peshon afërsisht sa dyfishi i peshës neto të bombolës.

2. Cfarë duhet të evitoni gjatë përdorimit të bombolave të gazit

- Mos u përpiqni të bëni asnjë veprim qoftë me kacavidë për të hapur valvulën apo termostatin e bombolës nëse vëreni rrjedhe gazi edhe pasi e keni mbyllur rubinetin e saj. Në këto raste kontaktoni menjëherë me personat e specializuar për këtë punë.
- Mos përdorni rrota gome që janë vendosur tek kapaku mbrojtës për të bërë vulosjen e nxjerrëses së flakës;
- Mos i mbani apo ti përdorni bombolat në bodrume apo nën nivelin e tokës. Dëndësia e gazit është më e madhe se ajo e ajrit dhe për pasojë nëse ka rrjedhje të gazit, ai do të përqëndrohet në nivele të ulëta, gjë që është mbytëse dhe përbën rrezik potencial për ndezje të tij kur ka kontakt me një burim energjie.
- Mos u përpiqni që të vendosni me forcë një rregullator të një madhësie të ndryshme për një bombol të një madhësie tjetër. Nëse keni ndonjë vështirësi kontaktoni një specialist të një pike të autorizuar të shitjes së gazit me pakicë për të kontrolluar bombolën/pajisjen tuaj.
- Asnjëherë mos u përpiqni të modifikoni pajisjen tuaj gazit. Gjithmonë pyesni një specialist të një pike të autorizuar të shitjes së gazit me pakicë dhe mos lejoni persona të pakualifikuar të cilët mund të dëmtojnë pajisjen tuaj.

3. Monoksidi i Karbonit

Monoksidi i karbonit (CO) është një gaz shumë helmues i cili mund të prodhohet nëse një pajisje nuk funksionon në mënyrë korrekte. Ky gaz nuk ka ngjyrë, erë apo shije e për rrjedhojë, është shumë e vështirë që ta evidentojmë.. Simptomat e helmimit nga CO janë të ngjashme me atë të një infeksion viral. Kjo ndikon në aftësinë mendore dhe e bën një person të paaftë dhe të pavetëdijshëm dhe ai nuk e kupton këtë gjë.

Simptomat e ekspozimit ndaj monoksidit të karbonit CO:

- Presioni lartë në pjesën e ballit të kokës së njeriut;
- Dhimbje e fortë koke;
- Dhimbje koke e pandërprerë, dobësi, marramendje, të vjella;
- Personi bie në koma me komplikacione të vazhdueshme;
- Çrregullim të aktivitetit të zemrës, frymëmarrje e ngadalësuar;
- Nëse ekspozimi ka qenë i rëndë mund të shkaktojë vdekjen.

Nëse dyshoni se vuani nga simptomat e mësipërme atëherë njoftoni Shërbimin e Specializuar për trajtimin e rasteve të rrezikuar nga Gazi Butani, lajmëroni nr. e urgjencës 127 dhe zjarrfikëses 128.

4. Rregullatori

Një rregullator duhet të vendoset ndërmjet një bombole dhe pajisjes (sobës, ngrohësit, furnelës, etj), me përjashtim të rasteve kur pajisja është e modifikuar në mënyrë të tillë që të bëhet furnizimi i saj direkt nga bombola pa patur nevojë për rregullator. Rregullatori është vendosur nga prodhuesi posaçërisht për të kontrolluar presionin e furnizimit dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të ndërhyet në të për adoptim. Nëse një rregullator tregon shenja të mos funksionimit, atëherë ai duhet të zëvendësohet. Rregullatorët duhet të shënohen me kodet **BS3016 ose BSEN12864**.

5. Tubat fleksibël të gazit

Përdorni vetëm tubat fleksibël të gazit të çertifikuara sipas **BS3212 ose BSEN1763** të cilat mbajnë vitin dhe emrin e prodhuesit, si GLN që përdor gomën natyrore për tubat fleksibël të gazit. Mbani gjatësisë e tubave të gazit sa më të shkurtër që të jetë e mundur. Të gjitha tubat e gazit duhet të sigurohen me fasheta të përshtatshme. Sigurohuni që tubat e gazit të jenë larg "pikave të nxehta" dhe të kryhet inspektimi i tyre herë pas here. Zëvendësojeni menjëherë një tubo gazi sapo të vëreni shenja plasaritje ose dëmtimi.

Tubat e gazit që përdoren për ngrohje duhet të shënohen me **BS3212 tipit 2** (ose BSEN1763 Klasa B) dhe të ketë një diameter prej 8mm brenda për brenda.

6. Këshilla të rëndësishme në rast emergjence

Nëse ju dyshoni se ka një rrjedhje, fikenit gazin menjëherë, hapni të gjitha dyert dhe dritaret dhe për të siguruar se nuk ka burim ndezjeje aty pranë shuani cigaren dhe fikni telefonin celular. Kontrolloni me kujdes të gjitha lidhjet e tubave. Nëse keni vështirësi në përcaktimin e rrjedhjes së gazit, atëherë lagni një sfungjer me ujë me shkumë dhe pasi të hapni gazin, kalojeni sfungjerin në të gjithë perimetrin e bombolës aty ku del gazi dhe tek tuboja. Vendi ku rrjedh gaz do të lëshojë filluska.


MOS PËRDORNI ASNJËHERË FLAKË PËR TË KËRKUAR PËR RRJEDHJE GAZI.

Një pajisje e përshtatshme mund të përdoret për testimin e përqendrimit të gazit LPG në ajër, por propani ka një të aromë të veçantë për të ndihmuar në zbulimin e rrjedhjeve.

Në rast të rënies së zjarrit:

- Aktivizoni alarmin nëse ka dhe lajmëroni menjëherë Zjarrfikësen duke i paralajmëruar për prezencën e gazit në ambient;
- Mbyllni të gjitha valvulat e bombolës së gazit;
- Mbani bombolën të ftohtë duke e spërkatur me ujë nëse është e mundur;
- Merr në telefon Shërbimin e Zjarrfikëss në numrin 128.



7. Lidhja e një cilindri 4.5 kg butan



Për bombulat 4.5kg përdoret një rregullator i cili vendoset direkt pas rubinetit. Rregullatori ka një bashkuese me fileto që lidhet me bombolën. Mos përdorni rondele gome nga kapaku i zi si gominë për vulosjen e rregullatorit.

1. Kontrolloni që valvula kryesore të jetë e mbyllur duke e rrotulluar në krahun e akrepave të orës;
2. Hiqeni kapakun e zi mbrojtës dhe ruajeni për përdorim në të ardhmen;
3. Kontrolloni mirë rondelen e zezë të rregullatorit para se të bëni lidhjen me bombolën. Ndërroni rondelen nëse është e dëmtuar;
4. Shtërngoni bashkuesen e rregullatorit me bombolën duke përdorur një çelës të posaçëm për të. Shtërngojeni fort, por mos e ekzagjeroni, pasi shtërngimi i tepërt mund të dëmtojë gominën/rondelen;
5. Në momentin që ju duhet të përdorni gazin hapeni valvulën e bombolës duke e rrotulluar në krahun e kundërt të akrepave të orës.

8. Çmontimi i një pajisje nga bombola me gas butan 4.5 KG




1. Asnjëherë mos bëni çmontim të rregullatorit apo tubos së gazit nga bombola pa mbyllur valvulën e saj;
2. Mbylleni valvulën kryesore të bombolës duke e rrotulluar në krah të akrepave të orës;
3. Prisni derisa flaka të ndalojë plotësisht. Nëse flaka nuk ndalon edhe pasi e keni mbyllur valvulën, hapeni atë përsëri dhe lajmëroni një specialist nga pika e autorizuar e shitjes së gazit;
4. Shkëputni rregullatorin me një çelës të përshtatshëm;
5. Ç'vidhos mbrojtësen e rregullatorit.

9. Montimi i bombolave me gas butan 7 kg, 12kg dhe 15kg

Ka disa tipe rregullatori 21 mm të përshtatshme për këto lloj bombolash. Ju lutem referojuni udhëzimeve të prodhuesit ose furnizuesit me gas për mënyrat e sigurta të montimit dhe çmontimit të rregullatorit të këtyre tip bombolave.

Bombolat 7 kg, 12kg dhe 15kg kanë një valvul 21mm dhe duhet të përdoret vetëm me një rregullator 21mm.




- 1 Rrotullojeni kapakun portokalli mënyrë që shigjeta të drejtohet në boshllëkun e duhur;
- 2 Hiqni kapakun e sigurisë portokalli duke tërhequr litarin e shkurtër lart. Mos përdorni mjete dhe të lini kapakun në lartësi;
- 3 Kontrolloni mirë nëse rondelja e zezë është brenda valvulës së bombolës;
- 4 Sigurohuni që ndezësi i rregullatorit është në pozicionin i ndarë’;
- 5 Vendosni rregullatorin 21mm, tek valvula e bombolës së gazit, sipas udhëzimeve të prodhuesit, furnizuesit të autorizuar;
- 6 Kur ju duhet të hapni gazin, hapni valvulën sipas udhëzimeve të përcaktuara nga prodhuesi dhe të vendosur/ngjitur në bombol.

Nëse rregullatori ngec gjatë lëvizjes nga pozicioni ndezje në fikje atëherë kjo do të thotë se lidhja nuk është bërë korrekte sipas udhëzimeve. Në këtë rast rregullatori duhet të shkëputet dhe të bëhet kujdes në ndjekjen me rigozitet dhe korrektësi të të gjithë hapave për ta rilidhur nga fillimi.

10. Çmontimi i bombolave me gas butan 7 kg, 12kg dhe 15kg

Ka disa tipe rregullatori 21 mm të përshtatshme për këto lloj bombolash. Ju lutem referojuni udhëzimeve të prodhuesit ose furnizuesit me gas për mënyrat e sigurta të montimit dhe çmontimit të rregullatorit të këtyre tip bombolave.

- 1 Asnjëherë mos e shkëputni Rregullatorin kur është valvula e hapur;
- 2 Më parë vendoseni rregullatorin në pozicionin kur valvula është e mbyllur;
- 3 Prisni derisa flaka të ndalojë plotësisht. Nëse flaka nuk ndalon edhe pasi e keni mbyllur valvulën, hapeni atë përsëri dhe lajmëroni një specialist nga pika e autorizuar e shitjes së gazit;
- 4 Për të çmontuar rregullatorin nga valvula ju lutem referojuni udhëzimeve të furnizuesit me gaz, dmth pikës së autorizuar;
- 5 Zëvendësoni kapakun e sigurisë ngjyrë portokalli mbi valvulë dhe pjesë të tjera të rregullatorit, kur nuk është në përdorim bombola.



Shënim:

Informacioni në këtë dokument ka për qëllim të japë udhëzime dhe besohet të jenë të sakta dhe të paraqesin praktikën e mirë në kohën e publikimit. Ajo nuk zëvendëson nevojën për të konsultuar dokumente të tjera zyrtare ku mund të kërkohet informacion i mëtejshëm.

Asnjë përgjegjësi ose detyrim nuk është pranuar nga hartuesit për ndonjë humbje ose dëmtim që dalin nga informacioni i dhënë.

Është e rëndësishme që përdoruesit e këtij publikimi përmbushin të gjitha obligimet ligjore, rregulloret, dhe standardet, në veçanti, ato në lidhje me sigurinë e gazit.